



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.361/2Prot.

Tiranë, më 02/04/2021

V E N D I M

Nr. 55, Datë 02/04/2021

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 151, datë 11.12.2020, e z. P.P., ku pretendohet diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar, nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Mbështetur në ankesën e sipërcituar rezulton se në datën 15.05.2018, si pasojë e një shkëndije elektrike, banesa e z. P.P. është djegur. Ankuesi ka bërë kallëzim penal pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me objekt “shkatërrim prone” kundër OSHEE sh.a., pasi e konsideron këtë shoqëri, përgjegjëse për dëmin e ndodhur. Ankuesi sqaron se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka filluar hetimet lidhur me rastin në fjalë.

Z. P.P. sqaron se pas disa muajsh, ka depozituar kërkesë për informacion pranë këtij institucioni, për të marrë dijeni mbi fazën, në të cilën ndodheshin hetimet. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër i ka dërguar përgjigje ankuesit nëpërmjet shkresës nr.6469/1, datë 19.07.2018, ku e bën me dije se çështja është nën hetim dhe në vijim është zhvilluar procesi gjyqësor, ku Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka vendosur kthimin e çështjes pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër për vazhdimin e mëtejshëm të hetimeve. Nga ky moment, ankuesi pretendon se nuk ka marrë asnjë njoftim mbi ecurinë e hetimit. Në datën 11.02.2020, z. P.P. sqaron se është paraqitur

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

pranë këtij institucioni për të marrë informacion, si dhe ka depozituar një kërkesë me shkrim, por nuk i është kthyer asnjëherë përgjigje mbi çështjen e tij.

Ankuesi shprehet se është pensionist dhe invalid pune, si dhe jeton me bashkëshorten e tij në pjesën e padjegur të banesës së tij, në kushte tepër të vështira. Ai pretendon se diskriminohet për shkak të aftësisë së kufizuar, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër, e cila është duke zvarritur hetimin e çështjes së tij. Sipas tij, zvarritja e kësaj çështjeje po kryhet edhe, sepse kallëzimi penal është kryer kundër OSHEE sh.a. që është një shoqëri, ku 100% të aksioneve i zotëron shteti.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a” të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i jep të drejtën për të hetuar dhe shqyrtuar ankesat e depozituara nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar, duke përcaktuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Neni 5, i Ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ndalon diskriminimin për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrjen në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, të një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë. Ndërsa, në Kreun III, të ligjit parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. Ky ligj në nenin 20, pikën 1 të tij parashikon se: “1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me

cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.”

Sipas nenit 7, të LMD-së, i ndryshuar, çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. Autoritetet publike kanë detyrimin për të promovuar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.

Hapat proceduriale të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Pas analizimit të ankesës nr. 151, datë 11.12.2020, së z. P.P., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7², të ligjit nr. 10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër me shkresën nr. 1730/1, datë 17.12.2020. Kjo shkresë iu dërgua për dajeni edhe ankuesit.

Në shkresë kërkohej informacioni vijues:

- Informacion i përgjithshëm mbi pretendimet e ankuesit;
- Informacion mbi fazën, në të cilën ndodhen hetimet e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, mbi çështjen që përbën objekt të kallëzimit penal të z. P.P.;
- Kopje e kallëzimit penal të z. P.P.;
- Kopje e vendimit (të vitit 2018) të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër mbi çështjen e djegies së banesës së z. P.P.;

² Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: *“Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.*

- Kopje të vendimit (vitit 2019) të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër;
 - Kopje të korrespondencës zyrtare të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër me z. P.P.;
1. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër nuk i dërgoi përgjigje shkresës së sipërcituar së KMD-së;
 2. Në vijim, Komisioneri iu drejtua sërish Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me shkresën nr. 297, datë 12.02.2021, ku i bëri kujtesë për kthim përgjigje dhe dhënie informacioni mbi pretendimet e ankuesit.
 3. Në përgjigje të shkresës nr. 297, datë 12.02.2021, së KMD-së, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër dërgoi shkresën nr. 297/1, datë 25.02.2021, nëpërmjet së cilës sqaron se pranë këtij institucioni është regjistruar procedimi penal nr. 1113/2018. Nga hetimet lidhur me këtë procedim penal ka rezultuar e provuar se në datën 15.05.2018, në vendin e njohur me emërtimin lagjia “Perlat Rexhepi”, rruga “Ludovik Saraçi”, ka rënë zjarr në banesën e shtetasit P.P.. Si pasojë e zjarrit të rënë, dy nga dhomat e kësaj banese janë djegur tërësisht. Djegia ka passjellë edhe rënie të çatisë, dëmtime të tavanit të korridorit, si dhe dëmtime në sendet e orenditë e banesës. Referuar aktit të ekspertimit teknik nr. 17, datë 25.05.2018, të hartuar nga ekspertët e fushës, për të zbuluar shkaqet mbi zjarrin e rënë në këtë banesë, rezulton se shkak i këtij zjarri ka qenë shkëndija elektrike nga rrjeti shumë i amortizuar.

Në këto kushte, Prokuroria ka kërkuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër pushimin e hetimit lidhur me këtë procedim penal. Gjatë seancës gjyqësore, i dëmtuari ngriti pretendimin se rrjeti elektrik në banesën e tij ka qenë në gjendje të rregullt teknike dhe se ndërhyrjet në këtë rrjet i ka bërë para pak vitesh. Ai theksoi faktin se shkak i zjarrit kanë qenë luhatjet e shumta të tensionit. I dëmtuari kërkoi mospranimin e kërkesës së Prokurorisë dhe kthimin e çështjes për hetime të mëtejshme nga ana e organit të prokurorisë. Nga ana e gjykatës është pranuar kjo kërkesë dhe janë lënë detyra konkrete lidhur me hetimin. Njëra prej detyrave të lëna nga ana e gjykatës është verifikimi i rrjetit elektrik të brendshëm. Verifikimi konsiston në kryerjen e ekspertizës nëse ky rrjet është në gjendje të rregullt teknike, kur mund të jenë bërë ndërhyrje në këtë rrjet dhe nëse ky rrjet është vërtet i amortizuar.

Në shkresë theksohet fakti se nga ana e Prokurorisë është bërë këqyrja në vend e banesës dhe kjo këqyrje është shoqëruar me marrje mostrash përcjellësi elektrik, pikërisht në dhomën ku është konstatuar vatra e zjarrit. Po kështu, është kryer këqyrje e rrjetit të brendshëm elektrik të banesës në fjalë. Sipas deklarimeve të familjarëve në pjesën e dëmtuar të banesës nuk është bërë asnjë ndërhyrje, që prej datës së ngjarjes dhe rrjeti në banesë është i pandryshuar.

Nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër është marrë vendim për kryerjen e ekspertimit teknik të rrjetit të brendshëm elektrik sipas përcaktimeve të gjykatës. Aktualisht, Prokuroria është në fazën e njohjes së të dëmtuarve dhe palës OSSH me pyetjet e shtruara në vendimin e ekspertimit, si dhe pritjes së përgjigjes nga ana e të dëmtuarit dhe OSSH-së, nëse kanë pyetje për të shtruar apo nëse ka pretendime lidhur me ligjshmërinë e ekspertëve.

Bashkëlidhur shkresës nr. 297/1, datë 25.02.2021, së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër është dërguar dokumentacioni i mëposhtëm:

- Vendim nr. 1401 (3758), datë 16.07.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër;
 - Kërkese për pushim çështjeje i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër;
 - Proçesverbal “Për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale”.
4. Në vijim të proçedurave hetimore, palët u njoftuan për seancë dëgjimore, e cila u vendos të realizohet në datën 18.03.2021, ora 11:00, pranë Zyrës së KMD-së.

Në seancë dëgjimore mori pjesë vetëm pala ankuese, e cila parashtroi edhe një herë pretendimet e saj për diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Z. P.P. theksoi faktin se çështja ishte zvarritur gjatë proçesit të hetimit nga ana e këtij institucioni dhe e vetmja gjë që ai kërkonte, ishte që organi i prokurorisë të dërgonte çështjen për gjykim përfundimtar në gjykatë. Ai theksoi faktin se pas fillimit të hetimit administrativ të ankesës së tij nga ana e Komisionerit, prokurori që kishte marrë në ngarkim hetimin e çështjes së tij dhe ekspertët përkatës ishin paraqitur në banesën e tij, ku ishin kryer ekspertimet e urdhëruara me vendim gjyqësor.

5. Në vijim të seancës dëgjimore, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër dërgoi shkresën nr. 2773, datë 17.03.2021, nëpërmjet së cilës informon se detyrat e lëna me vendimin nr. 1401, datë 16.07.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër janë kryer dhe procedimi penal është dërguar pranë kësaj gjykate për zgjidhje përfundimtare.
6. Ankuesi u njoh me informacionin e dërguar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe në vijim nëpërmjet e-mailit të datës 24.03.2021, ai kërkoi tërheqjen e ankesës, pasi qëllimi për të cilin është depozituar ankesa pranë KMD-së, është arritur.

Në këto kushte, u konsiderua se qëllimi, për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrotjtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet: “*Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa*”, KMD vlerësoi se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa. Njëkohësisht, në referencë të nenit 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i

Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”³, Komisioneri deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 1, nenin 5, 6 e 7, nenin 20, pika 1, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 9-10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Përfundimin e procedurës së shqyrtimit administrativ të ankesës nr. 151, datë 11.12.2020, së z. P.P., pasi u arrit efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Fusha – të mira dhe shërbime
Shkak –aftësi e kufizuar
Lloji i vendimit – pushim/tërheqje

³ Neni 94/1, i ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikon: “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë.”